



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

RAPORT VJETOR 2021

Oda e Mjekëve të Kosovës



Prill 2022

Prishtinë

Përmbajtja:

RAPORT VJETOR 2021	1
1. Infrastruktura Juridike	3
2. Këshilli Drejtues.....	3
3. Anëtarësimi	4
4. Mbikëqyrja etiko-profesionale	5
5. Edukimi i Vazhdueshëm Profesional	8
6. Licencimet.....	9
7. Edukimi specialistik-zbërthimi i kompetencës bazuar në Ligjin për Shëndetësi dhe Ligjin për OPSH-të	9
8. Këshilli Mbikqyrës	10
9. Komisioni për Çështje Etike i OMK-së.....	10
10. Komisioni për Solidaritet dhe Ndihmë Reciproke i OMK-së.....	10
11. Raporti Financiar	11
11.1 Gjendja financiare – 31 dhjetor 2021	11
11.2 Përkrahje për Edukim të Vazhdueshëm Profesional.....	12
11.3 Prokurimi.....	12
12. Aktivitete të tjera.....	13
12.1 Shërbimi profesional	13
12.2 Zgjedhjet për legjislaturën e III-të të OMK-së	13
12.3 Kongreset vjetore.....	14
12.4 Botimi i Revistës “Mjeku”	16
12.1 Obelisk kushtuar punëtorëve shëndetësor.....	16
12.2 Ndarja e Dekorativave dhe e Mirënjohjeve të OMK-së.....	17
12.3 Draftimi i aktit normativ për kompenzimin e familjeve të mjekëve dhe punëtorëve tjerë shëndetësor që humbin jetën në krye të detyrës	17
12.4 Huluntim - Të nxënit e harmonizuar/kompetencat e mjekëve të përgjithshëm	18
12.5 Huluntim - Kënaqshmëria e specialistëve me shkollimin specialistik në QKUK dhe Spitale Rajonale	18
12.7 Tryeza e rumbullakët - “Cilësia e studimeve në Fakultetin e Mjekësisë – UP “Hasan Prishtina” dhe strategjia nacionale për ruajtjen e funksionalitetit të sistemit shëndetësor të Kosovës ”	20
12.8 Tryeza e rumbullakët - “Kualiteti i shkollimit universitar dhe pasuniversitar i mjekëve”.....	20
12.9 Marrëveshja për bashkëfinancimin e projektit të profilizimit të mjekëve- Trajnime specifike jashtë vendit	20
12.10 Bashkëpunimi profesional dhe veprimtaria ekspertike	21
12.11 Marrëdhënie ndërkombëtare	21
13. Plani i veprimit për 2022	22
Projektet afatmesme dhe afatgjata.....	22

1. Infrastruktura Juridike

Kuvendi i Odës së Mjekëve të Kosovës gjatë vitit 2021 ka mbajtur tre mbledhje të rregullta. Në mbledhjet e datës 15 qershor dhe 9 nëntor u bë zgjedhja e anëtarëve të KQZ-së dhe gjithashtu u miratuan rregulloret dhe amandamentet për plotësim ndryshim të akteve normative si në vijim:

- Amendamentet për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores për Edukimin e Vazhdueshëm Profesional;
- Amendamentet për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores për Procedurat Vendimmarrëse të Organeve të OMK-së;
- Amendamentet për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores për Marketing;
- Amendamentet për Plotësimin dhe Ndryshimin e vendimit për taksat administrative;
- Miratimi i Kodit Zgjedhor i OMK-së
- Miratimi i Rregullores për Revistën Mjeku;

Në mbledhjen e datës 17 dhjetor Kuvendi i Odës së Mjekëve mbajti zgjedhjet për kryetar të OMK-së. Kuvendi si organi më i lartë i këtij institucioni përbëhet nga 139 anëtarë. Pas përfundimit të procesit zgjedhor në Kuvendin e Odës, sipas votimit të fshehtë Dr. Pleurat Sejdiu u rizgjedh në funksionin e kryetarit të OMK-së.

2. Këshilli Drejtues

Gjatë vitit 2021, Këshilli Drejtues i OMK-së ka mbajtur 12 takime, si dhe në 6 raste kanë votuar elektronikisht përmes e-mailit, ku janë pranuar 28 lëndë, nga të cilat janë marr 25 vendime sipas kërkesave/ankesave të pranuar.

Sfidat apo vështirësitë të cilat e kanë përcjellë Këshillin Drejtues të OMK-së gjatë vitit 2021 janë:

- Ligji për paga-vendimi i gjykatës kushtetuese - Avokimi i OMK-së
- Bartja e kompetencës për edukimin specialistik
- Sigurimi i parcellës për ndërtesën e OPSH-ve - refuzimi nga SHSKUK për ndarjen e një parcele brenda QKUK-së
- Zbatimi i Ligjit për Shëndetësi dhe Ligjit për OPSH-të
- Mospagesa e shtesave dhe kujdestarive në paga për të gjithë punëtorët shëndetësor gjatë kohës së pandemisë-Avokimi i OMK-së

3. Anëtarësimi

Anëtarësimi në Odën e Mjekëve të Kosovës ka filluar më datë 23 janar 2018. Gjatë vitit 2021 janë anëtarësuar 394 mjekë, si rezultat numri total ka arritur në 4717 mjekë, ku 3595 mjekë janë të punësuar në sektorin publik, 568 mjekë në sektorin privat, 511 mjekë të papunë dhe 43 mjekë pensionist.




Tabela 1 Anëtarësimi deri 31 dhjetor 2021




Tabela 2. Anëtarët e ndarë sipas moshës

Bazuar në tabelën më lartë shihet se mosha mesatare e mjekëve anëtar është 47 vjeç, anëtari më i ri është 25 vjeç, kurse anëtari më i vjetër është 86 vjeç.

Gjatë vitit 2021 për shkak të mos kryerjes së pagesës vjetore të anëtarësisë, janë ç'anëtarësuar 155 mjekë.

4. Mbikëqyrja etiko-profesionale

Për ta pasqyruar ecurinë e mbikëqyrjes etike dhe profesionale pranë organeve të odës, në mënyrë tabelare do të paraqesim ushtrimin e funksionit të tillë nga ana e organeve të odës.


Organi	Numri i lëndëve të pranuar për vitin 2021	Vendimet sipas procedurës së zhvilluar për vitin 2021	Sanksionet e shqiptuara për vitin 2021	Sanksionet e ekzekutuara për vitin 2021	Lëndët në shqyrtim
Prokurori i Odës	57	47	///	///	13
Këshilli Etik	40	50	Rekomandim kolegial – 7; Qortime publike – 6; Gjoba: 6 Gjithësej : 5,000.00€	Qortim publik 1 (50.00€) Rekomandime kolegjiale 1 (50.00€) Gjoba 0 (0.00€) Gjithësej: 00.00€ Shpenzime të paushallit : 850.00€	5
Gjyqi i Nderit	10	10	1.)Refuzohet ankesa GJN 08/2021 e Dr.Shukri Gërxhaliut ndaj Vendimit të Këshillit Etik KE 19-8/2021. 2.) Apropoet ankesa GJN	///	0

			<p>11/2021 kundër vendimit të Këshillit Etik KE KE 12.41-1/2021.</p> <p>3.) Hudhet si e palejshme ankesa e Dr.Drilon Zekaj ndaj vendimit të Këshilli Etik KE 22-10/2021</p> <p>4.) Aprovohet kërkesa GJN 02/2021 e kryetarti të Kshllit Etik</p> <p>5) Refuzohet ankesa GJN 03/2021 ndaj Vendimit të Këshillit Etik KE 74.49-14/2021.</p> <p>6) Refuzohet ankesa GJN 02/2021</p>		
Certifikatat e të kalurës etike	159	///	///	///	///


Në shqyrtim të drejtpërdrejtë, janë mbajtur gjashtë seanca të shqyrtimit kryesor, në të cilin është mundësuar përfaqësimi i drejtpërdrejt i palëve në procedurë, përfshirë të drejtën në përfaqësues me autorizim (prokurë).


Gjatë vitit 2021, janë lëshuar 159 certifikata për të kaluarën etike. Doktor të Mjekësisë janë 146 mjekë, kurse Specialist janë 13 mjekë. Mosha mesatare e mjekëve që janë paisur me certifikata është 31 vjet. Nga ta 82 janë meshkuj dhe 77 janë femra.

CERTIFIKATA PËR TË KALUARËN ETIKE



Mosha e mjekëve që kanë marr certifikata për të kaluarën etike





Gjatë vitit 2021 nga numri total i mjekëve që kanë kërkuar certifikata për të kaluarën etike, 71.69% apo 114 janë mjekë që kanë diplomuar tre vitet e fundit. Sipas statistikave certifikatë për të kaluarën etike kanë kërkuar 72 mjekë që janë duke vijuar shkollimin specialistik.


5. Edukimi i Vazhdueshëm Profesional

Komisioni për Edukimin e Vazhdueshëm Profesional gjatë vitit 2021, ka akredituar 137 aktivitete. Në kuadër të aktiviteteve të akredituara, pesëmbëdhjetë shoqata kanë bërë kërkesë për përkrahje financiare për organizimin e aktiviteteve, katër nga kërkesat janë refuzuar për përkrahje financiare kurse nënë kërkesa janë aprovuar nga Komisioni.



6. Licencimet

Komisioni për Licencim dhe Ri-licencim profesional gjatë periudhës janar-dhjetor 2021, ka organizuar 6 provime të rilicencimit dhe gjithashtu ka lëshuar 1014 licenca me kategoritë si në grafikun e më poshtëm:



Nga data e bartjes së kompetencës për licencim, ky komision i ka lëshuar gjithsej 3539 licenca. Në kriteret e Licencimit/Rilicencimit është edhe ndjekja e programeve për edukim të vazhdueshëm profesional ku mjekët janë të obliguar të fitojnë së paku 20 pikë kredituese në vit, gjegjësisht 100 pikë kredituese për 5 vite.

Bazuar në rrethanat e krijuara si pasojë e pandemisë COVID 19 dhe pamundësinë e organizimit të tubimeve shkencore, Komisioni për Edukim të Vazhdueshëm Profesional liron komunitetin e mjekëve nga obligimi i grumbullimit të së paku njëzet pikëve kredituese për vitin kalendarik 2020.

7. Edukimi specialistik-zbërthimi i kompetencës bazuar në Ligjin për Shëndetësi dhe Ligjin për OPSH-të

Dizajnimi dhe fillimi i fazës kalimtare të zbërthimit të kompetencave të edukimit specialistik (zbërthimi ligjor, financiar dhe teknik) është në proces e sipër, duke përfshirë edhe hartimin e UA-së për shkollim specialistik.

Por në ndërkohë, bazuar në Nenin 9, paragrafi 1, me nënparagrafin 1.7, të Ligjit për OPSH-të, si dhe Nenin 72, paragrafi 5, të Ligjit për Shëndetësi, OMK ka kërkuar auditim të procesit pasiqë ka konstatuar dhe faktuar një mori shkeljeve ligjore. Procesi i auditimit ka filluar nga ana e MSh-së.

8. Këshilli Mbikqyrës

Në periudhën kohore janar–dhjetor 2021, Këshilli Mbikëqyrës i OMK-së ka mbajtur dhjetë (10) takime, ku është bërë shqyrtimi i vendimeve të Këshillit Drejtues-ligjshmëria e tyre konform akteve juridike të OMK-së dhe ligjeve në fuqi.

9. Komisioni për Çështje Etike i OMK-së

Në vitin 2021, Komisioni për Çështje Etike i OMK-së ka pranuar 35 kërkesa për leje hulumtimi ka shqyrtuar 34 prej tyre.

32 kërkesat e parashtruara nga palët janë aprovuar, dhe aplikuesëve u janë lëshuar lejet për hulumtim, ndërsa dy kërkesa nuk janë aprovuar për shkak të mospërbushjes së kriterëve, ndërsa një kërkesë komisioni e ka kthyer për plotësim të lëndës.

Komisioni për Çështje Etike, gjithashtu ka nxjerrë vendim për miratimin edhe të një raporti si rezultat i implementimit të hulumtimit.

10. Komisioni për Solidaritet dhe Ndihmë Reciproke i OMK-së

Në vitin 2021, Komisioni për Solidaritet dhe Ndihmë Reciproke ka pranuar 14 kërkesa për përkrahje financiare. Komisioni ka nxjerrë 13 vendime pas aprovimit të kërkesave të parashtruara nga palët. Ndërkaq, një kërkesë komisioni do ta shqyrtojë në takimin e muajit janar, meqenëse e njejta është parashtruar pranë administratës së OMK-së me datë 30 dhjetor 2021.

11. Raporti Financiar**11.1 Gjendja financiare – 31 dhjetor 2021**

1.0 Të hyrat:					
1.1 Të hyrat e shtyera nga 2020	€475,907				
Total të hyrat e shtyera nga 2020	€475,907				
1.1 Të hyrat	Realizimi: TM1	Realizimi: TM2	Realizimi: TM3	Realizimi: TM4	TOTAL
1.1.1 Të hyrat nga anëtarësia:					
1.1.2 Anëtarësimi i mjekëve shtetas kosovarë	€ 264,512	€ 63,041	€ 17,345	€ 4,700	€ 349,598
1.1.3 Anëtarësimi i mjekëve shtetas jo kosovarë	€ 2,000	€ 5,500	€ 4,705	€ 1,000	€ 13,205
1.1.4 Licencimi	€ 9,700	€ 7,950	€ 10,820	€ 21,030	€ 49,500
1.1.5 Të hyrat e tjera*	€ 8,366	€ 6,645	€ 19,084	€ 16,858	€ 50,953
1.1.6 Xhirollogaria për ndërtimin e obeliskut në nder të profesionistëve shëndetësor-Projekt i përbashkët i OPSH-ve *			€ 1,700	€ 31,875	€ 33,575
Të hyrat deri me 31.12.2021	€ 284,578	€ 83,136	€ 53,654	€ 75,463	€ 496,830.70
Të hyrat e shtyera nga 2020	€475,907				
TOTAL TË HYRAT	€ 972,738				

2.0 SHPENZIMET	Shpenzimet: TM1	Shpenzimet: TM2	Shpenzimet: TM3	Shpenzimet: TM4	TOTAL
2.1 Paga, meditje dhe kontributet pensionale	€ 40,596	€ 49,786	€ 39,767	€ 84,060	€ 214,209
2.2 Material shpenzues	€ 4,923	€ 239	€ 782	€ 2,385	€ 8,328
2.3 Reprerentacioni	€ 642	€ 587	€ 587	€ 673	€ 2,489
2.4 Edukimi i vazhdueshëm profesional	€ 2,000	€ 3,250	€ 23,002	€ 27,065	€ 55,318
2.5 Shpenzimet e tjera*	€ 8,793	€ 7,931	€ 5,238	€ 15,642	€ 37,603
2.6 Shpenzimet e asetëve		€ 148	€ 1,167	€ -	€ 1,315
2.7 Përkrahje financiare në kuadër të fondit për solidaritet	€ 8,000	€ 4,250	€ 4,050	€ 8,400	€ 24,700
2.8 Xhirollogaria për ndërtimin e obeliskut në nder të profesionistëve shëndetësor-Projekt i përbashkët i OPSH-ve			€ 32	€ 19,970	€ 20,002
TOTAL SHPENZIMET 31.12.2021	€ 64,954	€ 66,191	€ 74,625	€ 158,194	€ 363,963

TOTAL BILANCI	€ 608,775
----------------------	------------------

1.1.5*Taksë administrative për aplikim për ndërrim të kartelës, Regjistrimi në regjistrin e anëtarësisë së OMK-së, Faksimili, Faksimili i dytë, Kongreset, simpoziumet, seminarët, konferenca vendore pa pjesëmarrje ndërkombëtare, aktivitet e organizuara nga kompanitë farmaceutike, Certifikatës për të kaluarën etike, Lejimi për hulumtime bio-mjekësore për anëtarë të Odës, Të hyrat nga dënimet (masat disiplinore), Dhurata / donacione, Të ardhurat të tjera .

2.5*Faksimili, Anëtarësimi në CPME, Shpenzimet e tel.,Shpenzimet e int., Shpenzimet e postës, Pajisje të IT, Shpenzime bankare, Shpenzimet e pastrimit,Shpenzimet e transportit, Inventari, Shpenzimet e tjera operative.

2.7*Tek përkrahja për solidaritet përveq mjeteve të ndara për mjekët të cilët kanë lënguar nga ndonjë sëmundje, janë të përfshira edhe mjetet e ndara për familjet e mjekëve të cilët kanë ndërruar jetë si pasoje e infektimit me virusin COVID19, bazuar në Vendimin e Këshillit Drejtues me nr. Ref. 53/20.

2.8* Në raportin financiar për periudhën derimë 31 dhjetor 2021, janë të përfshira edhe mjetet e menaxhuara nga OMK, të cilat janë në kuadër të projektit të përbashkët të Odave të Profesionistëve Shëndetësor, për ndërtimin e obeliskut "Për Jetën" kushtuar veprës dhe sakrificës së profesionistëve shëndetësor ndër dekada. Qëllimi i këtij njoftimi është se mjetet e bartur nuk janë pasuri e Odës së Mjekëve, por janë mjete të projektit i cili vazhdon edhe në vitin 2022.

11.2 Përkrahje për Edukim të Vazhdueshëm Profesional

Oda e Mjekëve të Kosovës gjatë vitit 2021 ka përkrahur financiarisht 9 aktivitete grupore për Edukim të Vazhdueshëm Profesional. Vlera totale e aktiviteteve të përkrahura është 63,977.25 €.

- Shoqatën e Gjinekologëve dhe Obstetërve të Kosovës në bashkorganizimin e “Kongresi i V –të të Obstetrikës dhe Gjinekologjisë në Kosovë”, me vlerë 4,800.00 €
- Shoqatën e Neonatologëve të Kosovës për organizimin e “Puntorisë – Follow up i të posalindurve në NILU”, me vlerë 2,500.00 €
- Shoqatën e Ortopedëve dhe Traumatologëve të Kosovës për organizimin e Seminarit “Rastet sfiduese në ortopedi në vitin e fundit”, me vlerë 1,658.00 €
- Shoqata e Neurologeve të Kosovës për organizimin e kursit “Ultrazëri i arterjeve karotide dhe vertebrale”, me vlerë 2,000.00 €
- Asociacionin e psikiatërve të Kosovës për organizimin e Konferencës një ditore “Sfidat në shëndetësinë mendore”, me vlerë 1,000.00 €
- Shoqatën e Kirurgëve Plastik, Rekonstruktiv dhe Estetik të Kosovës në vlerë prej 2,000.00 €
- Qendrën e Mjekësisë Urgjente Prishtinë në organizimin e “Trajnimit për procedurën e intubimit të pacientit në kushte paraspitalore”, me vlerë 1,250.00 €
- Kolegjin e Kirurgëve të Kosovës në bashkorganizimin e “Kongresin e Parë Klinik”, me vlerë 22,592.00 €
- Organizimi i Kongresit të Dytë të Mjekësisë në vlerë 24,177.25 €
- Shoqata Kosovare për Menaxhimin e Rrugëve të Frymëmarrjes në bashkorganizimin e “5th Advanced Airway Management workshop – Difficult Airway for Anesthesiologist and Surgeons”, me vlerë 2,000.00 €

11.3 Prokurimi

Gjatë vitit 2021 u zhvilluan nëntë procedura të hapura të prokurimit dhe një procedurë e negociuar e prokurimit :

Si rezultat i këtyre procedura të prokurimit u bë furnizimi i OMK-së me dekorata/pllaketa për mjekët që kanë dal në pension dhe për institucionet që kanë kontribuar në luftën kundër virusit COVID-19, si dhe u bë furnizimi i OMK-së me medalje përkujtimore.

Në muajin korrik u bë ftesa për tender nga Oda e Mjekëve të Kosovës për të gjitha kompanitë e interesuara që të paraqesin ofertën e tyre për dosje të tenderit/konkursit

për “Projektin ideor për Monumentin përkujtimor për nderë të profesionistëve shëndetësorë”. Si rezultat i kësaj ftese është pranuar ofertë nga një operator ekonomik, ku përzgjedhja e operatorit ekonomik u bë sipas konformitetit cilësor të shërbimit të ofruar, duke u mbështetur në arsyeshmërinë e çmimit të ofruar dhe pasi që operatori ekonomik ka plotësuar të gjitha kërkesat në përputhshmëri me kërkesat e dosjes së tenderit.

Në muajin tetor u zhvilluan me sukses procedura e prokurimit një burimor për organizimin dhe mbajtjen e Kongresit të II-të mjekësisë dhe procedura me vlera të vogla për transmetimin e Kongresit të Dytë të Mjekësisë në platformën zoom.

Në muajin nëntor u zhvillua procedura me vlera të vogla për organizimin dhe mbajtjen e mbledhjes së kuvendit të OMK-së legjislatura e II.

Gjatë periudhës tetor-dhjetor u zhvilluan dy procedura të hapura të prokurimit. Pas ftesave të bëra për tender nga Oda e Mjekëve të Kosovës në mënyrë që të gjitha kompanitë e interesuara të paraqesin ofertën e tyre për dosje të tenderit për furnizimin me faksimil për anëtarët e OMK-së. Këto dy procedura janë anuluar për shkak të mungesës së ofertave të pranuar. Procedura e tenderit për furnizimin me faksimil do të rishpallet.

Në muajin dhjetor u zhvillua procedura e negociuar e prokurimit për ndërtimin e monumentit përkujtimor për nderë të profesionistëve shëndetësorë. Procedura e prokurimit u zhvillua me sukses dhe sipas kontratës, monumenti përkujtimor duhet të ndërtohet brenda afatit 2 muajor.

12. Aktivitete të tjera

12.1 Shërbimi profesional

Pas aprovimit të organogramit nga Këshilli Drejtues, gjatë vitit 2021 sipas konkursit të hapur janë përzgjedhur një Zyrtare Administrative pranë Komisioneve të Përhershme dhe Zyrtare për Marrëdhënie me Publikun pranë OMK-së/Gazetare në Revistën e OMK-së

12.2 Zgjedhjet për legjislaturën e III-të të OMK-së

Kuvendi OMK-së, në mbledhjen e datës 15 qershor 2021, ka përzgjedhur Komisionin Qendror të Zgjedhjeve në përbërje prej:

1. Dr. Adem Nura, kryesues i KQZ-së,
2. Dr. Shaban Osmanaj zv. Kryesues,
3. Dr. Agron Kamberi, anëtar,

4. Dr. Rexhep Manaj, anëtar,
5. znj. Arbnora Duriqi, anëtare

KQZ i OMK-së ka caktuar datën 1 dhjetor 2021 për mbajtje të zgjedhjeve për anëtarë të kuvendit. Si rezultat i zgjedhjeve që janë mbajtur me 01 dhjetor, që është dëshmuar si një proces demokratik, është formuar Kuvendi i ri i OMK-së.

Kuvendi si organi më i lartë i këtij institucioni përbëhet nga 134 anëtarë, të cilët sot shfrytëzuan të drejtën e votimit dhe me anë të saj shprehën vullnetin për zgjedhjen e kryetarit të OMK-së.

Pas përfundimit të procesit zgjedhor në Kuvendin e Odës, sipas votimit të fshehtë Dr. Pleurat Sejdiu u rizgjodh në funksionin e kryetarit të OMK-së.

Mandati për legjislaturën e tretë të Kuvendit të OMK-së do zgjasë për 4 vitet e ardhshme.

12.3 Kongreset vjetore

Ndër aktivitetet kryesore që Oda e Mjekëve ka planifikuar të realizoj për vitin 2021 janë Kongreset vjetore Mjekësore.

Oda e Mjekëve përmes Kongreseve të organizuara ka për qëllim që anëtarëve të saj në fusha të caktuara t'u ofroj mundësinë që të fitojnë përvoja nga ekspertët e jashtëm me qëllim të ngritjes së kapaciteteve mjekësore për ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve të Kosovës.

Kongresi i Dytë i Mjekësisë - Onkologji

Me datë 14 tetor u bë hapja solemne e Kongresit të dytë të mjekësisë - Onkologji, ku të pranishëm ishin mysafir të ftuar, përfaqësues nga Ministria e Shëndetësisë, përfaqësues nga komisioni parlamentar për shëndetësi, ligjerues ndërkombëtar. Ndër aktivitetet kryesore ishte edhe promovimi i dy numrave të botuar deri më tani të Revistës Mjeku, ku të gjithë pjesëmarrësve ju dhurua nga një kopje.

Me dekorata dhe mirënjohje u ndan për nder të mjekëve që kanë ndërruar jetë gjatë vitit 2021. Profesionistët më të dalluar të fushës së mjekësisë pranuan dekoratën Nderi i mjekut “Ali Sokoli” dhe “Musa Haxhiu”, për kontributin e veçantë të dhënë në themelimin dhe zhvillimin e shërbimeve dhe institucioneve shëndetësore në Kosovë.

Pasi që gjendja me pandeminë gjatë muajit shtator është përmirësuar, këshilli organizativ i ka bërë kërkesë Qendrës operative emergjente të Kosovës për lejimin

e mbajtjes së kongresit për numër të caktuar të pjesëmarrësve (deri në 300 persona) në mënyrë fizike.

Gjatë dy ditëve të Kongresit morrën pjesë mbi 2500, në mënyrë virtuale dhe me prezencë fizike duke respektuar masat anti Covid. Ata patën rastin të ndjekin punimet shkencore nga ligjërues vendor dhe të huaj.

Mbi 58 ligjerata dhe punimeve u prezantuan ndarë në 8 sesione

- Pulmologji
- Trakti gastrointestinal
- Trakti urogenital
- Kokë dhe qafë
- Gjinekologji
- Gjiri
- Onkologji pediatrike
- Hematoonkologia

Kongresi i V –të i Obstetrikës dhe Gjinekologjisë në Kosovë

Shoqata e Gjinekologëve dhe Obstetërve të Kosovës së bashku me Odën e Mjekëve të Kosovës, me datë 22-23 Tetor, organizuan Kongresin e V –të të Obstetrikës dhe Gjinekologjisë në Kosovë.

Në këtë kongres u prezantuan tema që kanë të bëjnë me shëndetin e gruas, nënës dhe fëmijës. Kongresi u organizua në mënyrë fizike për numër të caktuar të pjesëmarrësve dhe për pjesën tjetër në mënyrë virtuale. Përgjatë ditëve të kongresit ishin mbi 1500 mjekë me prezencë fizike ose virtuale.

Pjesëmarrja në “Kongresin e Dytë të Mjekësisë – Onkologji” dhe në “Kongresinin e V –të të Obstetrikës dhe Gjinekologjisë” për të gjithë anëtarët e Odës së Mjekëve të Kosovës ishte pa pagesë.

Kongresi i Parë Klinik

Kolegji i Kirurgëve të Kosovës së bashku me Odën e Mjekëve të Kosovës, me datë 23-26 Shtator, organizuan Kongresin e Parë Klinik.

Në këtë kongres u prezantuan tema të ndryshme prej të gjitha disiplinave kirurgjike nga mbi 40 ligjërues të huaj dhe 50 vendorë. Kongresi u organizua në mënyrë fizike për numër të caktuar të pjesëmarrësve dhe për pjesën tjetër në mënyrë virtuale. Përgjatë ditëve të kongresit ishin mbi 600 kirurgë nga të gjitha specialitetet kirurgjike me prezencë fizike ose online.

12.4 Botimi i Revistës “Mjeku”

Me datë 30 mars 2021, në ditën ndërkombëtare të mjekëve, OMK bëri botimin e Revista Mjeku. Kjo revistë botohet për herë të parë në Kosovë, e cila trajton aktualitete të ndryshme nga mjekësia kosovare dhe më gjerë.

Revista Mjeku vjen si rezultat i vizionit dhe angazhimit të Odës së Mjekëve të Kosovës për një revistë informative që i dedikohet mjekut Kosovar dhe lexuesve tjerë potencialë të interesuar në aktualitetet e Shëndetësisë Kosovare. Këshilli Redaktues është i përbërë nga anëtarë të cilët i bashkon bagazhi i madh profesional dhe akademik, por edhe sensi i detyrimit për ta bërë gjithnjë një “hap tutje” në shëndetësinë tonë.

Tema bosht e numrit të parë të revistës është COVID-19. Gjithashtu, janë trajtuar edhe tematika tjera relevante.

Në mujin Korrik u bë publikimi i revistës me temë bosht “Onkologjia”. Artikujt interesantë të këtij numri prezantojnë aspekte të ndryshme të kësaj problematike të veçantë mjekësore.

Në muajin Tetor u bë publikimi i revistes me temë bosht “Kujdesi Parësor”. Artikujt interesant të këtij numri prezantojnë aspekte të ndryshme kujdesit parësor në shtetin tonë, aktualitetet ne OMK dhe disa artikuj tjerë relevant dhe cilësor.

Revista është e publikuar edhe online në faqën e Odës së Mjekëve të Kosovës (linku: [REVISTA MJEKU](#)) në mënyrë që të arrijë audiencë sa më të gjerë.

12.1 Obelisk kushtuar punëtorëve shëndetësor

Iniciativa për ngritjen e një obelisku në nderim të punës dhe sakrifices së punëtorëve shëndetësorë, u ndërmor nga vet Kryetari i OMK-së, qysh në Tetor 2020. Pas dhënies së mbështetjes për një iniciativë të tillë nga ana e Këshillit Drejtues të OMK-së, u është bërë ftesë për bashkëpunim dhe përkrahje edhe Odave tjetara të Profesionistëve Shëndetësor, e të cilat kanë shprehur gadishmërinë për bashkëorganizim dhe bashkëfinancim për realizimin e këtij projekti.

Odat e Profesionistëve Shëndetësor (OPSH), pas dakordimeve të detajeve të projektit, i janë drejtuar Kryetarit të Komunës së Prishtinës me kërkesë për ndarjen e një hapësire për ndërtimin e këtij obelisku,

Në muajin maj 2021, Kuvendi Komunal i Prishtinës aprovoi projektin dhe ndau parcelën e kërkuar nga OPSH-të.

Ky monument do nderoj sakrificat ndër dekada të punëtorëve shëndetësorë, si në periudhën e helmimit të nxënësve dhe përkujdesjen e të plagosurve të demonstartave gjithëpopullore të viteve '80-të, atëherë në vitet e 90-ta kur regjimi i kohës i hodhi në rrugë, ata në mënyrë të organizuar përmes shoqatës “Nëna Terezë”; Lufta e UÇK-së dhe tani lufta e fundit me COVID-19.

Obesliku është paraparë të jetë me përmasa të përafërta 2.5 metra i gjerë dhe deri në 10 metra i gjatë, kjo në vartësi prej projekteve konkurruese.

12.2 Ndarja e Dekoratave dhe e Mirënjohjeve të OMK-së

Gjatë këtij tremujori Oda e Mjekëve të Kosovës ka ndarë mirënjohje dhe dekorata për mjekët në pension në shenjë falenderimi për kontributin e tyre jetësor gjatë karierrës së tyre dhe për institucionet shëndetësore që kanë kontribuar në luftën kundër COVID-19. Dekorata Nderi i Mjekut “Ali Sokoli” është ndarë në nderim të mjekëve të cilët kanë ndërruar jetë si pasojë e infektimit me virusin COVID-19. Dekorata për arritje shkencore “Musa Haxhiu” është ndarë për mjekun Dr Flamur Blakaj. Medalje përkujtimore janë ndarë në nderim të mjekëve të cilët kanë ndërruar jetë përgjatë viteve 2019-2021. Me mirënjohjen e OMK-së gjithashtu janë nderuar mjekët të cilët kanë dalur në pension përgjatë vitit 2020.

12.3 Draftimi i aktit normativ për kompensimin e familjeve të mjekëve dhe punëtorëve tjerë shëndetësor që humbin jetën në krye të detyrës

Si rrjedhojë e situatës me pandeminë COVID-19, ku një numër i konsiderueshëm i mjekëve dhe punëtorëve tjerë shëndetësor kanë humbur jetën në shërbim të pacientëve si rezultat i infektimit me COVID-19, dhe të cilët duke qenë mbajtës të familjes apo kryefamiljarë me vdekjen e tyre u është rrezikuar drejtëpërdrejtë mirëqënia e anëtarëve të familjarëve të tyre. Andaj me datë 12 janar, Oda e Mjekëve të Kosovës ka bërë kërkesë drejtuar Kryeministrit dhe Ministrit të Shëndetësisë, për iniciimin e procedurave për draftimin e aktit normativ për kompensimin e familjeve të mjekëve dhe punëtorëve tjerë shëndetësor që humbin jetën në krye të detyrës.

Pas kërkesës së bërë nga Oda e Mjekëve të Kosovës drejtuar Kryeministrit dhe Ministrit të Shëndetësisë, kjo e fundit ka formuar komisionin për hartimin e rregullores për kompensimin e familjeve të mjekëve dhe punëtorëve shëndetësor që humbën jetën në krye të detyrës nga COVID-19, pjesë e së cilës është edhe inicuesi Oda e Mjekëve të Kosovës.

12.4 Hulumtim - Të nxënit e harmonizuar/kompetencat e mjekëve të përgjithshëm

Oda e Mjekëve të Kosovës në bashkëpunim me Trupin Këshillëdhënës të Fakultetit të Mjekësisë ka lansuar anketën me temë: Rezultatet e të nxënit të harmonizuar/kompetencat për Mjekët e përgjithshëm. Kjo anketë është hartuar për doktorët e rinj për të vlerësuar njohuritë që ata marrin pas përfundimit të Fakultetit të Mjekësisë, si dhe për shefat e reparteve përkatëse për të marrë vlerësimin e tyre për doktorët e rinjë që i mentorojnë.

Ky hulumtim kishte për dizajn hulumtues metodat deskriptive, me zgjedhje të mostrës të randomizuar. Mostra është përcaktuar përmes kalkulimit të numrit të personave reprezentues të target grupit, që në këtë hulumtim ishin doktorët e rinj. Numri i pjesëmarrësve u përcaktua për të dhënë rezultate signifikante me besueshmëri 95%, i cili ishte 489 pjesëmarrës (doktor të rinjë). Për analizimin e mëtejshëm të rezultateve të nxjerra nga anketimi i doktorëve të rinjë, u përcaktua edhe mostra e shefave të reparteve të cilët dhanë mendimin e tyre në raport me specializantët e rinjë. Në mostrën e grupit të dytë (shefat e reparteve) janë përfshirë 45 pjesëmarrës.

12.5 Hulumtim - Kënaqshmëria e specializantëve me shkollimin specialistik në QKUK dhe Spitale Rajonale

Ky projekt ka për qëllim vlerësimin e kënaqshmërisë dhe përmbushjes së pritshmërive së specializantëve mbi shkollimin specialistik që ata e përcjellin në QKUK dhe Spitale Rajonale. Vlerësimi realizohet nëpërmjet pyetësorit me 14 pyetjeve (të hapura dhe të mbyllura) që do ju shpërndahet specializantëve në institucionet e lartcekura. Përmes pyetësorit synohet të bëhet vlerësimi i kënaqshmërinë mbi mbarëvajtjen e mësimit teorik, mësimit praktik, kushtet e punës, angazhimi i mentorit dhe rekomandimet e specializantëve për përmirësimin e cilësisë së shkollimit të tyre.

Më tutje analiza e të dhënave do të bëhet me Paketën SPSS, dhe rezultatet do t'i bashkangjiten pyetësorit të mëparshëm "Të nxënit e harmonizuar/Kompetencat për Mjekësinë e Përgjithshme" për të nxjerrë konkludimet dhe rekomandimet mbi mbarëvajtjen e shkollimit specialistik.

12.6 Hulumentim/Pyetësor rreth vaksinimit të mjekëve

Vaksinimi për COVID-19 ka fillar në fillim të dhjetorit 2020 dhe që nga 15 Shkurt 2021, 175.3 milion doza vaksinash janë administruar. Të paktën 7 vaksina të ndryshme (3 platforma) janë administruar.

OBSH ka nxjerrë një Listë të Përdorimit Emergjent (EUL) për vaksinën Pfizer COVID-19 më 31 Dhjetor 2020. Më 15 Shkurt 2021, OBSH lëshoi EUL për dy versione të vaksinës AstraZeneca / Oxford COVID-19, prodhuar nga Serum Institute of India dhe SKBio. Deri në qershor 2021, OBSH mund të nxjerr listë të përdorimit emergjent edhe për produkte tjera të vaksinave.

Pasi që vaksinat demonstrohen të jenë të sigurta dhe efikase, ato duhet të autorizohen nga rregullatorët kombëtar, të prodhohen sipas standardeve të kërkuara dhe të shpërndahen. OBSH po punon me partnerë në të gjithë botën për të ndihmuar në koordinimin e hapave kryesorë në këtë proces, përfshirë edhe për të lehtësuar qasjen e barabartë në vaksinat e sigurta dhe efektive COVID-19 për miliarda njerëz që do të kenë nevojë për to.

Oda e Mjekëve të Kosovës ka bërë hulumentim rreth akceptueshmërisë të vaksinimit tek mjekët, ku qëllimi kryesor i hulumentimit ka qenë përcaktimi i nivelit të mundshëm të pranimit apo refuzimit dhe faktorët që ndikojnë në refuzimin e një vaksine COVID-19.

Në hulumentim janë përfshirë 2273 mjekë nga të tre nivelet shëndetësore, ku nga të gjithë pjesëmarrësit, 94.3% janë përgjigjur që janë të gatshëm ta marrin njërën nga vaksinat e aprovuara.

5.7% kanë dhënë përgjigje refuzuese, ku pjesa më e madhe e tyre apo mbi 50% e tyre si arsye e refuzimit të vaksinimit kanë dhënë “pasigurinë ndaj efekteve anësore”. Pjesa tjetër e mjekëve që kanë refuzuar kanë treguar mos besim ndaj vaksinave në përgjethsi.

Qytetarët e Kosovës në rrugën e vetme të besimit dhe informimit rreth vaksinimit e kanë Mjekun. Prandaj rezultatet e këtij hulumentimi do duhej të jenë një tregues se popullata nuk ka nevojë të frikësohet apo të jenë skeptik rreth vaksinimit kur vet mjekët i besojnë asaj.

12.7 Tryeza e rrumbullakët - “Cilësia e studimeve në Fakultetin e Mjekësisë – UP “Hasan Prishtina” dhe strategjia nacionale për ruajtjen e funksionalitetit të sistemit shëndetësor të Kosovës ”

Oda e Mjekëve të Kosovës në bashkëpunim me Fakultetin e Mjekësisë UP, organizoi me sukses Tryezën e rrumbullakët me titull ”Cilësia e studimeve në Fakultetin e Mjekësisë – UP “Hasan Prishtina” dhe strategjia nacionale për ruajtjen e funksionalitetit të sistemit shëndetësor të Kosovës”.

Pjesëmarrës në këtë tryezë ishin Dekanja e Fakultetit të Mjekësisë – UP, Prof. Dr. Suzana Manxhuka- Kërliu, Kryetari i Odës së Mjekëve të Kosovës, Dr. Pleurat Sejdiu, Ministri i Shëndetësisë, Prof. Dr. Rifat Latifi, Rektor i UP-së Prof. Dr. Naser Sahiti, etj.

Qëllimi i kësaj tryeze është diskutimi mbi rëndësinë e përgatitjes së aspektit shkollor, dhe ndikimi pozitivisht në të ardhmen e sistemit shëndetësor.

12.8 Tryeza e rrumbullakët - “Kualiteti i shkollimit universitar dhe pasuniversitar i mjekëve”

Me datë 22 korrik 2021 u mbajt Tryeza e rrumbullakët me temën “Kualiteti i shkollimit universitar dhe pasuniversitar i mjekëve”. Në tryezë morrën pjesë përfaqësues nga Ministria e Shëndetësisë, Bordi i Drejtorëve të ShSKUK-së, Rektorati i Unisversitetit të Prishtinës, Përfaqësues nga dekanati i Fakultetit të Mjekësisë, Bordi Qëndror për Shkollim Specialistik, Kryetarët e OPSH-ve, Përfaqësues të projektit Lux-Dev, Përfaqësues të specializantëve etj.

Qëllimi i kësaj tryeze është diskutimi mbi atë se çfarë na ka brengosur deri tani, e ndër to është në mos reflektimin i shumë problemeve që kanë atakuar mjekësinë tonë dhe qasjen e specializantëve në Kosovë.

Nga hulumtimet e bëra nga OMK, del si rezultat se 34.4% prej specializantëve kanë vlerësuar që planprogrami nuk është përmbushur aspak.

12.9 Marrëveshja për bashkëfinancimin e projektit të profilizimit të mjekëve- Trajnime specifike jashtë vendit

Në muajin dhjetor, Oda e Mjekëve të Kosovës dhe projekti Lux Dev nënshkruan marrëveshjen për bashkëfinancimin e projektit të profilizimit të mjekëve- Trajnime specifike jashtë vendit

Për shkak të besimit të treguar përgjatë bashkëpunimit shumëvjeçar mes Odës dhe projektit të mbështetur financiarisht nga qeveria e Luksemburgut dhe Kosovës (projekti KSV/017), dhe duke pas parasysh kredibilitetin dhe profesionalizmin e Odës së Mjekëve të Kosovës në kryerjen e funksioneve publike, është nënshkruar marrëveshja e partneritetit mes Odës së Mjekëve të Kosovës dhe projektit Lux Dev.

Projekti ka alokuar një vlerë prej 120,000.00€ për implementimin e aktiviteteve që kanë të bëjnë me ngritjen e kapaciteteve të Odës, si dhe mbështetjen për organizimin të trajnimeve profesionale-profilizimeve për një numër të përzgjedhur të mjekëve nga spitalet e përgjithshme të Gjilanit dhe Prizrenit.

12.10 Bashkëpunimi profesional dhe veprimtaria ekspertike

Në kuadër të kompetencës publike lidhur me mbikëqyrjen e veprimtarisë profesionale dhe në kuadër të bashkëpunimit ndërinstucional lidhur me veprimtarin profesionale të mjekëve, Kryetari i OMK-së duke u bazuar në kompetencat ligjore sipas Ligjit për OPSH-të, në bazë të kërkesave nga Gjykatat dhe prokurorit publike të Kosovës, ka caktuar ekspert apo grupe të ekspertëve lidhur me konstatimin e përgjegjësisë profesionale mbi zbatimin e procedurave mjekësore nga mjekët gjegjës. Ekspertiza të tilla kanë qenë në shërbim të konstatimit të përgjegjësisë individuale të mjekëve të cilët i janë nënshtruar procedurave penale apo civile, qoftë në fazën hetimore apo gjatë shqyrtimeve gjyqësore

Organi	Numri i lëndëve të pranuar për vitin 2021	Vendimet sipas urdhëresave së pranuar për vitin 2021	Në procedurë	Raportet e ekspertizave të përfunduara për vitin 2021	Lëndët e bartura nga periodat paraprake
Kryetari i Odës	2	1	0	2	0

12.11 Marrëdhënie ndërkombëtare

Në kuadër të marrëdhënieve ndërkombëtare Oda e Mjekëve të Kosovës morri pjesë në konferencën virtuale të organizuar nga Forumi Evropian i Shoqatave Mjekësore (EFMA). Temë e konferencës ishte "Luftimi i pandemisë - A duhet të jetë një opsion vaksinimi i detyrueshëm?"

Konferenca u përqendrua në çështjen e vaksinimit COVID-19 dhe u mbajt në një format debati ku u shpalosën argumente për mbështetje dhe kundër vaksinimeve vullnetare dhe të detyrueshme.

Në këtë konferencë morrën pjesë edhe zyrtarë të tjerë të rëndësishëm të fushës së mjekësisë në nivelin Evropian.

Kryetari i OMK-së, në këtë konferencë raportoi për situatën aktuale në Kosovë sa i përket pandemisë COVID-19, si dhe shpjegoi situatën dhe procesin e vaksinimit.

Gjatë vitit 2021 Oda e Mjekëve ka pasur raportime të rregullta edhe me CPME me qëllim të koordinimit me vendet tjera lidhur me menaxhimin e përgjithshëm të COVID-19 në Kosovë (mbrojtja ndaj COVID-19 dhe mjetet mbrojtëse të disponueshme për mjekë, protokole, numri i testeve, llojet e barnave, hapësirat e disponueshme për pacientët dhe info tjera)

13. Plani i veprimit për 2022

Projektet afatmesme dhe afatgjata

- Projekti për ndërtimin e një objekti për të gjitha OPSH-të mbështetur nga MSH-ja, financuar nga Projekti KSV/017 “Përkrahja për Sektorin e Shëndetësisë”. Kësaj iniciative i janë përgjigjur të gjitha OPSH-të dhe kërkesa zyrtare për mbështetje është nënshkruar nga të gjitha ato dhe më pas është dorëzuar në MSH. Fillimi i ndërtimit pritet pas dhënjes së përlqimit nga ana e ShSKUK-së dhe MSh-së për parcelën për ndërtim. Përlqimi pritet javëve në vijim
- Pas miratimit të kërkesës nga OMK drejtuar LuxDev-it lidhur me përkrahjen financiare për zhvillimin e sistemit informativ/bazës interaktive të të dhënave, ku do të përfshihen të gjitha proceset e OMK-së. Kohëzgjatja e projektit është 1 vit.
- Zbërthimi dhe bartja e kompetencave për edukimin specialistik bazuar në Ligjin për Shëndetësi dhe Ligjin për OPSH-të.
- Botimi i numrave në vazhdimësi të “Revistës Mjeku”
- Organizimi i Kongresit të III multidisiplinar me fokus COVID-19